



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



NJOFTIM PËR OPERATORË EKONOMIK

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) njofton të gjithë **Operatorët Ekonomik** vendorë që janë të regjistruar dhe janë aktiv ne platformë të prokurimit elektronik, që për çfarëdo ndryshimi të të dhënave të biznesit në Agjencion për Regjistrim të Bizneseve (ARBK) dhe Administratë Tatimore (ATK), që për pasojë ka ndryshim/ndërrim të emërimit ose numrit fiskal/biznesit, janë të obliguar që menjëherë vetë t'i përditësojnë të dhënat në platformë të prokurimit elektronik.

Përditësimi i të dhënave bëhet në pajtim me hapat, udhëzimet dhe veprimet e ilustruara si më poshtë:

1. Shfrytëzuesi i OE (me rolin Admin OE) duhet të jetë i kyqur në sistem të prokurimit elektronik;
2. Në menynë **“Të dhënat e mia”** zgjedh nën-menynë **“Organizata ime”**;
3. Tek të dhënat “Organizata ime” fshij numrin e vjetër fiskal dhe shëno numrin e ri fiskal apo numrin e unifikuar të biznesit dhe klikon butonin “PLOTESO”;
4. Kontrolllo të dhënat tek emri i biznesit, nëse emri i biznesit nuk është paraqitur sic duhet (ne pajtim me emrin e biznesit apo emrit tregtar), atëherë kliko butonin “ Anulo” poshtë në të majtë dhe kontakto ATK-në për përditësim korrekt të të dhënave. Kontrollimi i të dhënave të emrit të biznesit duhet të bëhet sidomos nga bizneset individuale.
5. Nëse të dhënat e kontolluara janë në rregull, atëherë kliko butonin “Ruaj”.
6. Me klikimin e butonit “Ruaj” të dhënat e biznesit janë përditësuar me numrin e unifikuar të biznesit

Detajet e organizimit

Operatorët ekonomikë në biznes të regjistruar në Kosovë duhet të shënojnë vetëm numrin fiskal, dhe të dhënat e tyre kryesore do të plotësohen automatikisht nga ATK. Operatorët ekonomikë të jashtëm duhet t'i plotësojnë vetë të gjitha shtënimet.

Të dhënat bazë

Titulli* Numri fiskal

Lloji i personit Numri i regjistrimit të biznesit (vetëm për OE nga Kosova)

Shteti

HAPI 3:
Pas shtypjes se butonit "Ploteso",
kontrollo/verifiko te dhenat e emrit
te biznesit

HAPI 1:
Fshij numrin e vjeter fiskal dhe sheno
numrin unik identifikues te biznesit.

HAPI 2:
Pas shenimit te numrit te unifikuar
te biznesit, kliko butonin
"PLOTESO"

| Tipi i adresës | Adresa | Numri postal | Vendi | Telefoni | Telefaksi | E-posta | Vërejtje |
|----------------|----------|--------------|-----------|-----------|-----------|----------------|----------|
| Sella | Pristine | 100000 | Prishtine | 044444444 | | email@test.com | |

TË DHËNAT E MIA

- Të dhënat personale
- Organizata ime**
- Shfrytëzuesit e mi
- Ndryshimi i fjalëkalimit
- Ndryshimi i pyetjes sekrete dhe përgjigjes
- MESAZHET

Nese emri i biznesit i verifikuar ne hapin nr.3 eshte ne rregull atehere shtyp butonin "RUAJ"

Pas ri-kyqjes ne sistem verifiko edhe njehere te dhenat e perditesuara tek "Organizata ime", nese ne fushoret e Nr fiskal dhe Nr te biznesit eshte Nr i unifikuar fiskal/biznesit.

Nese emri i biznesit i verifikuar ne hapin nr.3 nuk eshte ne rregull atehere anulo perditesimin duke shtypur butonin "ANULO"